REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 1860 Prot. Tiranë, më 01.08.2025

VENDIM QARKULLUES

Nr. 89 datë 01.08 2025

"PËR

PROPOZIMIN E PLANIT STRATEGJIK TË ZHVILLIMIT TË UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS PËR PERIUDHËN 2026-2031"

Në zbatim të nenit 38, pika "b" të Ligjit Nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL e Republikës së Shqipërisë", nenit 7, pika 12 të Rregullores së UST, Vendimit të Rektoratit Nr. 86, datë 29.07.2025 "Për propozimin e Planit Strategjik të zhvillimit të Universitetit të Sporteve të Tiranës për periudhën 2026-2031", Senati Akademik i UST-së,

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin e Planit Strategjik të Zhvillimit të Universitetit të Sporteve të Tiranës për periudhën 2026-2031 bashkëlidhur këtij Vendimi.

2. Ky Vendim i përcillet për miratim Bordit të Administrimit.

3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK
Prof. Dr. Agron Kasa

Prof. Asoc. Arben Kaçurri

Dr. Aisel Oseku

Prof. Dr. Dhurata Bozo

Prof. Asoc. Elton Spahiu

Prof. Asoc. Ferdinand Mara

Prof. Asoc. Fisnik Brovina

Prof. Asoc. Klotilda Vrenjo

Prof. Asoc. Kujtim Kapedani

Prof.Asoc. Oltiana Petri

Prof. Dr. Robert Çina

Prof.Asoc. Robert Çitozi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS

PLANI STRATEGJIK I ZHVILLIMIT

UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS

2026 – 2031

Rr. M. Gjollesha, 1001 Tiranë; Tel: 35542226652; www.ust.edu.al; contact@ust.edu.al

Përmbajtja

1. **Hyrje**
2. **Sfondi**
3. **Vizioni, misioni, parimet, vlerat**
4. **Përparësitë strategjike, objektivat, veprimet, rezultatet e pritshme**
5. **Plani i veprimit**

HYRJE

Universiteti i Sporteve të Tiranës është i vetmi institucion i lartë publik i këtij lloji në Republikën e Shqipërisë në funksion të përgatitjes së mësuesve të edukimit fizik, specialistëve të sportit, të fitnesit dhe aktivitetit fizik për shëndet, të menaxherëve të sportit e turizmit, si dhe rehabilitimit nëpërmjet lëvizjes fizioterapist.

Universiteti realizon kualifikimin e plotë shkencor të specialistëve të edukimit fizik, sporteve, aktivivitetit fizik dhe rekreacionit, duke mbyllur të tre ciklet e studimit. Fillesat e Universitetit të Sporteve të Tiranës nisin me ngritjen e Teknikumit të Fiskulturës në vitin 1948, si e para shkollë e mesme që përgatiste mësuesit e ardhshëm të edukimit fizik.

Pas 10 vjetësh, në vitin 1958, pas krijimit të Universitetit të Tiranës, krijohet dega e fizkulturës pranë Fakultetit 2-vjeçar Histori – Filologji. Më vonë kjo degë u kthye në fakultet me destinacionin "Mësues i Edukimit Fizik" për shkollat e ulëta dhe të mesme.

Në vitin 1960 me Vendim të Këshillit të Ministrave, Nr. 394, datë 28.09.1960, krijohet Instituti i Fizkulturës, i cili një vit më vonë, po me Vendim të Këshillit të Ministrave emërtohet "Vojo Kushi" me një afat studimesh 3-vjeçar, i njëjtë me sistemin universitar të shkollave të larta.

Në vitin 1962 pranë ILKF 'Vojo Kushi", ngrihet qendra shkencore, e cila më vonë u kthye në sektor shkencor. Ky sektor për kohën dhe në të ardhmen, do të ndihmonte në evidentimin e përpunimin e mendimit bashkëkohor shkencor në fushën e edukimit fizik e sporteve.

Duke filluar nga viti 1966 struktura e ILKF ka funksionuar mbi bazën e katedrave si njësia bazë mësimore e kërkimore shkencore. Nga viti 1994 mbi bazën e departamenteve.

Në vitin 1971, po me Vendim të Këshillit të Ministrave, emërtesa ndryshon në Instituti i Lartë i Kulturës Fizike "Vojo Kushi". Në vitin 1993 afati i studimeve në këtë institucion bëhet 4-vjeçar.

Më 25.05.2000, me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 266, ky Institucion emërtohet Akademia e Edukimit Fizik dhe Sporteve "Vojo Kushi".

Me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.123 datë 17.02.2010, ky Institucion emërtohet Universiteti i Sporteve të Tiranës (UST) duke patur në përbërjen e tij dy fakultete dhe një Institut Kërkimor Shkencor të Sportit.

Në zbatim të Urdhrit të MASR nr. 495 datë 11.10.2019 "Për hapjen e Fakultetit të Shkencave të Rehabilitimit", Urdhrit nr. 245 datë 22.07.2020 "Për hapjen e programit të Studimit Bachelor në "Shkenca të Rehabilitimit" është miratuar njësia e katërt në Universitetin e Sporteve të Tiranës.

Nga viti 1958 e deri më sot, Universiteti i Sporteve të Tiranës si institucion unik në vendin tonë, ka diplomuar në mënyrë sistematike Mësues, Trainerë dhe Specialistë të Lartë të Fushës së Edukimit Fizik Sportit, Fitnesit e Rekreacionit, Menaxher të Sportit dhe Rehabilitues nëpërmjet Lëvizjes Fizioterapist.

Sot në Universitetin e Sporteve të Tiranës studiojnë në të gjitha ciklet e studimit më shumë se 1800 studentë, të cilët janë pjesë e Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes, i cili përgatit Mësues të Edukimit Fizik dhe Shëndetësor, Fakultetit të Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit, i cili përgatit Trajnerë Fitnesi dhe Menaxherë të Sportit e Turizmit, si dhe Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit që përgatit Rehabilitues nëpërmjet Lëvizjes Fizioterapi. Një kontribut shumë të

rëndësishëm jep edhe Instituti i Kërkimit Shkencor të Sportit me studimet e tij, të cilat kanë rëndësi jo vetëm për institucionin, por edhe më gjerë.

UST është një institucion i akredituar nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë - ASCAL dhe gëzon një reputacion të shkëlqyer si në Shqipëri ashtu edhe jashtë vendit. Ai ka marrëveshje bashkëpunimi me shumë universitete të rajonit dhe evropiane dhe është partner në disa projekte të rëndësishme evropiane.

Universiteti i Sporteve të Tiranës përbëhet nga katër njësi kryesore:

1. **Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes**
    a. Departamenti i Edukimit dhe Shëndetit;
    b. Departamenti i Sportive Kolektive;
    c. Departamenti i Sporteve Individuale.
2. **Fakulteti i Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit**
    a. Departamenti i Veprimtarisë Fizike, Rekreative dhe Turizmit;
    b. Departamenti i Organizimit dhe Menaxhimit;
    c. Departamenti i Lëvizjes dhe Shëndetit.
3. **Instituti i Kërkimit Shkencor të Sportit**
    a. Departamentin e Performancës Sportive;
    b. Departamentin e Aktivitetit Fizik dhe Shëndetit;
    c. Departamentin Projekteve dhe Teknologjisë.
4. **Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit**
    a. Departamenti i Disiplinave Biomjekësore dhe Humane;
    b. Departamenti i Kineziologjisë;
    c. Departamenti i Rehabilitimit.

UST ka përfunduar fazën e parë të zhvillimit të tij strategjik duke u bërë një universitet, i cili ka në përbërjen e tij 3 fakultete dhe një institut kërkimor-shkencor si njësi kryesore. Aktualisht UST ka filluar fazën e dytë të zhvillimit të tij duke ofruar dy programe të ciklit të tretë të studimeve "Doktoratë" në "Shkencat Sportive" dhe në "Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti".

Plani strategjik 2026 – 2031 përshkruan llojet e ndryshimeve dhe mënyrave të transformimit nëpër të cilat do të kalojë universiteti. Ne presim arritjet që do të realizohen përmes këtij plani.

Kuadri i planit strategjik është produkt i analizës dhe konsultimit të gjerë me stafin, studentët, të diplomuarit, partnerët dhe palët e interesuara. Ky plan është përgatitur duke marrë në konsideratë gjithashtu tre dokumentet kryesore, të cilat janë Raporti i vetëvlerësimit të UST (përgatitur nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm, 2024), Vlerësimi Institucional i Institucioneve të Arsimit të Lartë në Shqipëri (Raporti për UST përgatitur nga APAAL dhe QAA, në vitin 2022), dhe disa linja themelore të riorganizimit, një koncept dokument i përgatitur nga Prof.Dr. Agron Kasa, Rektori aktual i UST-së i paraqitur gjatë fushatës për zgjedhjen e autoriteteve drejtuese të UST në maj – qershor 2024.

Plani do të mbështesë zgjedhjet që ne do të bëjmë gjatë periudhës së ardhshme të zhvillimit të Institucionit tonë. Këto zgjedhje duhet të jenë besnike ndaj trashëgimisë sonë dhe vlerave të reja që na ka dhënë, duke iu përgjigjur një konteksti në ndryshim të shpejtë. Plani strategjik vendos një agjendë të nivelit të lartë për UST, e cila varet në masë të madhe edhe nga mjedisi i jashtëm. Ne kemi hartuar Planin Strategjik për të përmbushur aspiratat tona.

Zbatimi i Planit Strategjik përfshin tre procese:
a. ndryshimin e kulturës;
b. përmirësimin e strukturës;
c. ndryshimin e procesit.

Ne do të monitorojmë progresin përkundrejt prioriteteve, angazhimeve dhe qëllimeve tona duke përdorur tregues relevantë të performancës, standardet dhe objektivat. Përmes kësaj do të ruajmë fokusin në Planin Strategjik, duke siguruar që ai të vazhdojë të plotësojë nevojat akademike, të mundësojë që t'i përgjigjemi mjedisit të jashtëm dhe ta përditësojmë sipas nevojës. Procesi vjetor i planifikimit dhe buxhetimit do të sigurojë kuadrin për zbatimin e Planit Strategjik.

SFONDI

UST është një institucion i arsimit të lartë që ka shkuar gjatë një procesi zhvillimi të vazhdueshëm në tregun akademik vendas e rajonal. Ai ka një mision të përcaktuar qartë për të përmbushur nevojat e arsimit të lartë nëpërmjet:

- Formimit universitar të studentëve e të specialistëve në të gjitha ciklet e studimeve.
- Kualifikimit të punonjësve akademikë e shkencorë në fushat e edukimit fizik, shëndetit dhe rekreacionit, si dhe rehabilitimit nëpërmjet lëvizjes fizioterapist.
- Nxitjes së kërkimeve e të studimeve në fushat e edukimit fizik dhe sporteve, veprimtarisë fizike, shëndetit dhe rekreacionit.
- Ofrimit të shërbimeve për të tretët dhe konsulenca në fushën e edukimit fizik dhe sporteve, veprimtarisë fizike, shëndetit dhe rekreacionit.

UST ofron programe studimi në përputhje me tendencat e tregut kombëtar dhe ndërkombëtar. Strukturat për programet e studimit janë të përcaktuara në rregulloret dhe dokumentacionin e kurrikulës. Strukturat e programit janë në përputhje me Objektivat e Procesit të Bolonjës.

Hulumtimi menaxhohet institucionalisht nga Instituti i Kërkimit Shkencor të Sportit, mbështetur nga planet e departamenteve. Stafi akademik është i angazhuar në projekte kërkimore dhe botime. UST boton revistën e saj shkencore.

UST ka zhvilluar strukturat e duhura të qeverisjes dhe kapacitetin e menaxhimit për të mbështetur një popullatë prej rreth 2000 studentësh të ciklit të parë dhe të dytë. Aftësimi i studentëve për punë është mundësuar nëpërmjet praktikave dhe punëdhënësit janë shumë pozitivë për njohuritë dhe aftësitë e studentëve dhe të diplomuarve të UST-së.

Ndërtesat dhe hapësira e përdorura nga UST përmbushin të gjitha normat ligjore dhe janë të përshtatshme dhe të mirëmbajtura dhe një pjesë e tyre kërkojnë të rikonstruktohen për t'iu përshtatur standardeve. UST ka zhvilluar gjithashtu një ambicie me synim afatgjatë për të zgjeruar e modernizuar në vijimësi infrastrukturën ekzistuese.

Objektet infrastrukurore të cilat ndodhen në territorin e kampusit të Universitetit të Sporteve të Tiranës, janë si më poshtë:

- Godina Kryesore me tre Kate;
- Godina e Rikonstruktuar E UST-së me katër Kate;
- Godina me dy Kate;
- Godina e Palestrës së Lojrave Sportive;
- Palestra e Gjimnastikës;
- Palestra e Fitnesit;
- Salla e Konferencave dhe Leksioneve;
- Biblioteka;
- Stadiumi Olimpik dhe Ambientet e Jashtme Sportive (Fusha e Minifutbollit, Hendbollit dhe dy Fushat e Tenisit).

Problemet kryesore të deritanishme mund të përmblidhen në *pesë aspekte*:

Organizimi i brendshëm

Për shkak të evolucionit historik të UST-së ndër vite, faza e tanishme e zhvillimit dhe stili i veprimit tregon disa përmirësime. Nga pikëpamja e financimit UST gjendet kryesisht nën financim publik dhe nga të ardhurat. Aktualisht UST duhet të zgjerojë gamën e shërbimeve të ofruara, me qëllim ndryshimin cilësor të raporteve të financimit. Në këtë mënyrë, duke rritur financimin nga burime të tërthorta, UST ka mundësi dhe fleksibilitet financiar për të realizuar objektivat ambicioze të planit strategjik. Kjo mënyrë e sigurimit të burimeve shtesë financiare paraqet një sërë problemesh kontabël dhe ligjore, të cilat duhet të zgjidhen në përputhje me kuadrin legjislativ në Republikën e Shqipërisë. Në këtë mënyrë institucioni do të garantojë një pavarësi relative të shtuar në formën e përdorimit të buxhetit të tij.

Marrëdhëniet studentore gjithashtu kanë nevojë të përmirësohen në organizimin e veprimtarinë tyre duke punuar fort që brenda kuadrit legjislativ qeveria studentore të jetë më efektive.

Bazat e të dhënave në lidhje me personelin dhe studentin nuk janë të digjitalizuara në mënyrë të plotë, gjë që kufizon mundësinë e të gjitha departamenteve dhe njësive për qasje dhe vlerësim të lehtë. Përveç kësaj, cilësia dhe vlerësimi standard nuk janë të organizuara plotësisht në nivelin që institucionet analoge ndërkombëtare më të spikatura të tregut akademik të fushës kanë.

Qëndrimi ndaj tregut

UST është një institucion publik jofitimprurës. Rritja e tij, ndikimi arsimor dhe shoqëror varet nga cilësia e tij, vlerësimi i tregut dhe numri i studentëve. Shkencat që mësohen dhe lloji i diplomave të dhëna duhet të pasqyrojnë nevojat e tregut dhe shoqërisë shqiptare në zhvillim. Në fakt, praktika ndërkombëtare tregon një marrëdhënie të ngushtë mes sistemit arsimor, shoqërisë dhe tregut specifik të punës. Një marketing i fortë, duke hulumtuar çdo aspekt të kësaj

marrëdhënieje komplekse dhe duke nxitur reformat e nevojshme, përbën një element të domosdoshëm në funksionimin dhe rritjen e suksesshme të UST-së.

Duke marrë parasysh numrin e madh të institucioneve të arsimit të lartë në Shqipëri të liçensuara së fundmi edhe në fushën e sporteve dhe edukimit fizik si dhe numrin e madh të kuotave të ofruara të regjistrimit nga këto institucione, konkurrenca për studentët është bërë më e vështirë. Një faktor tjetër që duhet mbajtur parasysh ka qenë edhe rritja e notës mesatare për studentët që aspirojnë shkencat e edukimit në fushën e sporteve.

UST duhet të marrë në konsideratë propozimin për hapjen e programeve të reja bachelor, master dhe të ciklit të tretë (doktoraturë apo master ekzekutiv) që asnjë universitet nuk ofron në vend apo rajon, për të përmirësuar cilësinë e kushteve të mësimdhënies dhe studimit në mënyrë që të jetë më tërheqës.

Politikat e komunikimit

Në kontekstin e revolucionit të sotëm të informacionit, politikat e komunikimit janë të rëndësishme në tre drejtime:

Së pari, projeksioni i imazhit të drejtë të UST-së në ambientin e jashtëm, veçanërisht në sistemin shqiptar të arsimit të lartë;

Së dyti, ndërtimi i një sistemi të fuqishëm dhe efikas të komunikimit të brendshëm, si në nivelin teknik të kompjuterizimit ashtu edhe në nivelin njerëzor të mirëkuptimit të mirë dhe të shëndoshë, midis udhëheqjes universitare, personelit akademik dhe stafit administrativ, ndihmës mësimor e studentëve;

Së treti, krijimi i një rrjeti të gjerë, por efektiv të kontakteve, mbështetjes së ndërsjellë dhe njohjes me universitetet e tjera në baza ndërkombëtare.

Është shumë e rëndësishme që UST të bëhet një qendër moderne e të mësuarit dhe kulturës nëpërmjet hulumtimeve të përbashkëta ose projekteve të tjera, programeve të shkëmbimit të studentëve dhe bashkëpunimeve të tjera.

Sigurimi i Cilësisë

Pasaporta e një universiteti modern për njohjen sociale dhe dallimin ndërkombëtar është përsosmëria akademike. Kjo mund të arrihet vetëm nëse të gjitha pjesët përbërëse, p.sh. stafi akademik dhe administrativ, punojnë shumë brenda një strukture të shëndoshë organizative. Mjeti kryesor për të siguruar këtë është një sistem i brendshëm i përhershëm i sigurimit të cilësisë bazuar në standardet kombëtare dhe ndërkombëtare.

Angazhimi i studentëve dhe palëve të interesuara

Në një shoqëri të lirë, demokratike, asnjë nga kërkesat e mësipërme nuk mund, ose duhet të zbatohet, nga lart-poshtë. Ato duhet të zhvillohen në një bashkëveprim harmonik me trupën e studentëve dhe një ndjenjë të fortë pronësie mbi reformat radikale të përfshira nga të gjithë aktorët kryesorë: Ministria e linjës që mbulon arsimin e lartë dhe sportet si financues, Senati Akademik, Bordi i Administrimit, Administrata dhe kryesisht studentët.

Kjo nënkupton kanale komunikimi të hapura dhe të sinqerta midis të gjithë palëve të interesuara. Udhëheqja në këtë proces paraqitet në bashkëveprim me trupën akademike dhe të studentëve. Marrëdhënia nuk mund të jetë e *ex-cathedra*, por një bashkëpunim, që synon përsosmërinë akademike dhe sociale kolektive. Kjo atmosferë nuk mund të mbahet vetëm me rregullore. Ajo përfshin një numër faktorësh që duhet të hulumtohen dhe zbatohen nga të dy palët e interesuara. Një atmosferë e hapur e dialogut gjatë ligjëratave dhe sesioneve të tjera të ofruara nga stafi mësimdhënës, një politikë e hapur për akademikët dhe për studentët dhe një diskutim i hapur për reformat dhe ndryshimet themelore para se të vendosen nga organi përkatës i universitetit, janë shembuj të mirë lidhur me këtë çështje.

Ekzistojnë dy elemente shtesë, të cilët janë çelësa për marrëdhëniet e harmonizuara me studentët: njëra është një karrierë efikase dhe shërbim punësimi i ofruar nga UST për studentët dhe tregun. E dyta është një sistem nxitësish për studentët.

Nevojat financiare për fazën e ardhshme të zgjerimit

Përmirësimi i organizimit dhe zgjerimi i UST-së do të kushtojë shumë në shpenzimet operacionale. Nga ana tjetër, pagesat për shkollim dhe tarifa të tjera të ngarkuara aktualisht për studentët janë më të ulëta në krahasim me institucionet e tjera private të arsimit të lartë që ofrojnë programe të njëjta apo të ngjashme me ato që UST ofron. Në këtë situatë UST duhet të rishikojë politikën financiare.

Sfida më e madhe për UST tani është organizimi me efektiv i universitetit si një qendër moderne e të mësuarit dhe kulturës, si një universitet i standardeve dhe njohjes ndërkombëtare.

VIZIONI, MISIONI, PARIMET, VLERAT

Vizioni

UST qendër moderne e të mësuarit dhe kulturës, sportit për transformimin e jetës.
UST synon të mbetet model i arsimit të lartë publik, i karakterizuar nga përgatitje rigoroze akademike dhe kërkim i thelluar shkencor, një institucion arsimor i zgjedhjes së parë për studentët e angazhuar në transformimin e jetës së tyre dhe të shoqërisë. UST është përgjegjëse për ofrimin e të gjitha programeve të studimit me kohë të plotë, programe studimi me karakter profesional, programe studimi në të tre ciklet, në fushën e edukimit fizik e sporteve, aktivitet fizik për shëndet, menaxhimit sportiv, rekreacionit e rehabilitimit, miratuar me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

Misioni

Misioni i UST-së është t'i shërbejë shoqërisë nëpërmjet arsimimit, hulumtimit, inovacioneve; nxitjes së zhvillimit individual për transformimin e jetëve, sigurimin e suksesit të studentëve në një mjedis global, ofrimin e shërbimeve akademike dhe zhvillimin e një komuniteti të larmishëm dhe gjithëpërfshirës.
UST është një universitet publik me status të veçantë, që ofron gamë të plotë të programeve të nivelit bachelor, master dhe studime doktorale. Universiteti kontribuon në zhvillimin e shoqërisë, përmes tri shtyllave të misionit të arsimit të lartë publik: kërkim shkencor, edukim, si dhe shërbim ndaj publikut, që vazhdimisht e pasurojnë dhe e informojnë njëra-tjetrën. UST ofron edukim me në qendër studentin, si dhe nxit rritjen

personale dhe intelektuale, për të përgatitur studentë për karriere produktive dhe qytetare, të përgjegjshëm në një shoqëri globale.

UST ka për mision:

a. formimin universitar të studentëve e të specialistëve në të tre ciklet e studimit;
b. kualifikimin e punonjësve akademikë e shkencorë në fushën e edukimit fizik, shëndetësor dhe të sporteve, veprimtarisë fizike, shëndetit, rekreacionit, turizmit, menaxhimit sportiv dhe rehabilitimit;
c. nxitjen e kërkimeve e të studimeve në fushën e edukimit fizik, shëndetësor dhe sportiv, veprimtarisë fizike, shëndetit, rekreacionit, turizmit, menaxhimit sportiv e rehabilitimit;
d. thellimin e kualifikimit profesional e shkencor të specialistëve të lartë në këto fusha;
e. ofrimin e shërbimeve për të tretët dhe konsulenca në fushën e veprimtarisë së edukimit fizik shëndetësor dhe sportiv, veprimtarisë fizike, shëndetit, rekreacionit, turizmit, menaxhimit sportiv e rehabilitimit.

Parimet bazë

- Përqëndrimi në cilësi dhe përsosmëri.
- Vendosja e studentëve në qendër të institucionit.
- Vlerësimi i të gjithë personelit dhe mbështetja që ata të shkëlqejnë.
- Diversiteti i vlerave dhe promovimi i barazisë.
- Mendo globalisht, vepro lokalisht dhe angazhohuni personalisht.
- Qasje ndërkombëtare për të gjitha aktivitetet tona.

Vlerat thelbësore

Të mësuarit pajis të diplomuarit për të jetuar jetë të shëndetshme, racionale, krijuese, produktive dhe parimore.

Përsosmëri akademike është sigurimi i përvojave më të larta të arsimit dhe të të mësuarit të mundësuar nga staf mësimor akademikisht dhe profesionalisht të kualifikuar, mundësi për të nxënët kontekstual, infrastrukturë mësimore mbështetëse, mjedis të bukur dhe burime efektive të nevojshme për të mbështetur të mësuarit në nivelin më të lartë.

Përgjegjësia shihet në lidhje me detyrën e marrjes së vendimeve bazuar në kontekst dhe duke mbajtur parasysh pasojat e veprimeve.

Integriteti përfshin ndershmërinë dhe drejtësinë, qëndrueshmërinë në mësimdhënie, etikën, lirinë e hetimit dhe angazhimin e hapur dhe të sinqertë me komunitetin përmes komunikimit, politikave dhe praktikave efektive.

Diversiteti si ndryshim i kuptimit, zhvillon respektin për pluralizmin etnik, kulturor dhe fetar; një ndërgjegje ndërkombëtare; dhe një vlerësim për vlerën e pafund të çdo personi; pasuron një ambient mësimi të fokusuar në përgatitjen e individëve për të jetuar dhe punuar në një shoqëri globale.

Partneriteti që vepron në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar me individë, grupe dhe institucione brenda dhe jashtë UST-së për të zhvilluar partneritet, bazuar në besimin dhe respektin, të cilat janë të dobishme reciproke si për UST-në ashtu edhe për partnerët e saj.

Parimet nga të cilat udhëhiqet UST-ja janë:

a. Liria e mendimit dhe e shprehjes;
b. Autonomia në mësimdhënie dhe kërkim shkencor;
c. Transparenca;
d. Meritokracia;
e. Kolegjialiteti;
f. Mosdiskriminimi.

PRIORITETET STRATEGJIKE, OBJEKTIVAT, VEPRIMET, REZULTATET E PRITSHME

PRIORITETI STRATEGJIK 1: ZHVILLIMI INSTITUCIONAL

Ndërsa ne jemi të përkushtuar në përmbushjen e misionit tonë, ne do të duhet të krijojmë një institucion të qëndrueshëm që është i aftë të investojë në shpërndarjen dhe mbështetjen e arsimit dhe kërkimit dhe të forcojë aftësinë e tij për t'iu përgjigjur efektivisht ndryshimeve të mundshme në të ardhmen në mjedisin e jashtëm në të cilin vepron. Deri në vitin 2031, UST synon të rrisë numrin e studentëve me 25 për qind duke iu përgjigjur mundësive të reja. Rritja në madhësi do të shoqërohet me rritjen e stafit në numër dhe hapjen e programeve të reja të studimit dhe përmiresimin infrastrukturor. Një rritje e tillë kërkon një qëndrueshmëri financiare të institucionit. Në këtë kuadër, po projektojmë transformimin e madhësisë institucionale dhe formës dhe strukturës së financimit.

Objektivi i parë: Të riformësohet struktura institucionale në funksion të përmbushjes së vizionit dhe misionit të institucionit.

Veprimet

- Të riformësohet struktura institucionale për të përmbushur vizionin dhe misionin e fokusuar në fushën e sporteve, edukimit fizik, shëndetit dhe mirëqenies, bazuar në studimin e tregut.
- Të riformatohet struktura institucionale në përputhje me dokumentet e UNESCO-s dhe kuadrit legjislativ mbi Arsimin e Lartë:
  - ISCED Fushat e Arsimit dhe Trajnimit 2013 (ISCED-F 2013)
  - Klasifikimi ndërkombëtar i arsimit
  - Fushat e arsimit dhe trajnimit 2013 (ISCED-F 2013) - Përshkrimet e fushave të detajuara

Rezultatet e pritshme

- Riorganizimi i fakulteteve ekzistuese.
- Riorganizimi i departamenteve ekzistuese.
- Riorganizimi i Institutit të Kërkimit të Shkencave Sportive
- Krijimi i departamenteve të reja.
- Krijimi i qendrave të kërkimit dhe zhvillimit brenda njësive kryesore.
- Riorganizimi i strukturës administrative në funksion të zhvillimit institucional.

Objektivi i dytë: Organizimi dhe qeverisja efektive.

Dizenjimi dhe qeverisja efektive organizative është jetësore. Ne duhet të dimë që kemi udhëheqjen e duhur, proceset vendimmarrëse dhe llogaridhënien e duhur për të ofruar këtë strategji.

Veprimet

Përgatitja e dokumenteve të politikave vijuese:

- Planifikimi i markës dhe identitetit strategjik.
- Plani i zhvillimit të infrastrukturës.
- Strategjia e internacionalizimit.
- Strategjia e partneritetit.
- Politika për zhvillimin e kurrikulave.
- Politika e sigurimit të cilësisë.
- Politika e qëndrueshmërisë së institucionit.
- Politika për rekrutimin dhe promovimin e stafit.
- Politika për rekrutimin dhe pranimin e studentëve.
- Strategjia e kërkimit.
- Politika e vlerësimit të studentëve.
- Përmirësimi dhe plotësimi i kuadrit rregullator.
- Krijimi dhe funksionimi i organizmave të reja, si komisionet e përhershme, Bordi i Partnerëve.
- Miqtë e UST-së.

Rezultatet e pritshme

- Dokumentet e politikave dhe planeve të veprimit.
- Përdorimi i kuadrit rregullator, si: rishikimi i Statutit, Rregullores së përgjithshme, rregulloreve të programeve të studimit, rregulloreve të organeve drejtuese akademike,

rregulloreve të komisioneve të përhershme, rregulloreve të administratës, rregullimit të sigurimit të cilësisë.

- Funkionimi i Komisioneve të përhershme
- Komisioni i Promovimit të Personelit Akademik.
- Komisioni i Projekteve dhe Botimeve Shkencore.
- Komisioni i Sigurimit të Standardeve të Cilësisë.
- Komisioni i Kurrikulave.
- Komisioni i mbarëvatjes së veprimtarisë dhe marrëdhënieve me studentët.
- Funksionimi i Bordit të Partnerëve.
- Funksionimi i Bordit Miqtë e UST-së.

Objektivi i tretë: Krijimi i burimeve për sukses afatgjatë.

Synojmë të zhvillojmë një mjedis kulturor dhe pune që inkurajon njerëzit që të rrisin cilësinë e gjithçkaje që bëjmë së bashku. Në punën tonë do të duhet të ndryshojmë se si të mundësojmë, mbështesim dhe motivojmë stafin për të ofruar strategjinë tonë. Gjithashtu na duhet një udhëheqje e qartë dhe një komunitet i aftë që punojnë së bashku për të arritur qëllimet dhe ambiciet tona të përbashkëta.

Veprimet

- Do të mbështesim zhvillimin e vazhdueshëm profesional të të gjithë stafit në mënyrë që ata të jenë efektivë në rolet e tyre aktuale dhe të zhvillohen e të përparojnë brenda institucionit tonë.
- Do të përgatisim personelin për rolet udhëheqëse dhe menaxheriale në fillim të karrierës së tyre në mënyrë që ata të kenë përvojën e gjerë të nevojshme për të marrë rolet me përgjegjësi më të madhe, me përkushtim të barabartë për ndërtimin e gjeneratës së ardhshme të shërbimeve akademike, profesionale.
- Sistemet tona të IT-së do të ofrojnë një shërbim që mbështet arsimin dhe hulumtimin.
- Do të mbështesim krijimin e hapësirave fizike dhe virtuale, të cilat janë të përshtatshme për mësimdhënie efektive, për të mësuar dhe për të mundësuar partneritetet tona.
- Do të sigurojmë një sistem të brendshëm të komunikimit që lejon stafin që të gjejë gjithçka që i nevojitet shpejt dhe të kryejë punën e tyre në mënyrë efikase dhe efektive.
- Do të krijojmë burime për sukses afatgjatë.

Rezultatet e pritshme

- Funksionimi i sistemeve të IT-së për të gjitha aktivitetet e institucionit.
- Trajnim për zhvillim profesional.

Objektivi katërt: Vendosja e studentëve në zemër të Universitetit tonë dhe t'i bëjmë ata partnerë aktivë në edukimin e tyre.

Veprimet

- Krijimi i një sërë parimesh si bazë për punën e partneritetit ndërmjet studentëve dhe stafit.
- Përfshirja e studentëve në marrjen e vendimeve në lidhje me politikat dhe praktikat e mësimdhënies dhe të nxënit.
- Kërkimi i fidbekut nga studentët për përvojën e tyre arsimore, përgjigja dhe veprimi mbi bazën e saj.
- Mbështetja e studentëve për të marrë pjesë në jetën më të gjerë universitare dhe në komunitete të tjera.
- Bashkëpunimi me Këshillin e Studentëve për të ofruar një sërë aktivitetesh dhe mjedisesh sociale, sportive, artistike, kulturore dhe të tjera.
- Mbështetja dhe inkurajimi i studentëve të përfshihen plotësisht në jetën universitare përmes klubeve studentore dhe ngjarjeve akademike dhe sociale.
- Promovimi i aktiviteteve që bashkojnë grupe të ndryshme të studentëve.
- Mbështetja dhe inkurajimi i studentëve për vullnetarizëm dhe për të marrë pjesë në aktivitete të tjera brenda komuniteteve lokale.
- Sigurimi i ambienteve fizike dhe digjitale, të cilat i mbështesin studentët në pjesëmarrjen aktive në jetën universitare.
- Krijimi i një qendre për aktivitete jashtëkurrikulare për të siguruar aktivitete sportive, kulturore, artistike, sociale dhe vullnetare, për mësimin joformal të studentëve.

Rezultatet e pritshme

- Dokumenti i politikave të partneritetit mbi punën e partneritetit midis studentëve dhe stafit.
- Instrumentet e fidbekut të studentëve për përvojën arsimore në UST.
- Qendra për aktivitete jashtëkurrikulare jashtëshkollore.
- Mbështetje për veprimtarinë e Këshillit të Studentëve.

Objektivi pesë: Forma e planit financiar

Përpilimi i kësaj strategjie do të kërkojë investime afatgjata të mbështetura nga një plan financiar i fortë. Përveç se Universiteti është institucion publik, kjo do të përqendrohet në gjenerimin e të ardhurave dhe shpenzimet e menaxhimit, duke rritur të ardhurat tona për investime në prioritetet strategjike.

Infrastruktura , burimet financiare, sistemi i informacionit

Objektivat

a. Shfrytëzimi i plotë i kapaciteteve të godinave, auditorëve, kabineteve, laboratorëve, palestrave, terreneve sportive, nëpërmjet një menaxhimi e shfrytëzimi efikas në nivel universiteti;

b. Rritja e sipërfaqeve për përdorim, nëpërmjet një risistemimi të të gjithë hapësirave të klasave, duke shfrytëzuar çdo mundësi ekzistuese të hapësirës së UST-së;

c. Investime të fuqishme në ndërtimin e mjediseve e terreneve sportive të nivelit bashkëkohor (Rikonstruksion i Godinës Kryesore, shtesa e Palestrës së Gjimnastikës, ndërtimi i një ndërtese 7-katëshe, ndërtimi i pishinës etj;

d. Rritje e nivelit të mirëmbajtjes të sallave të leksioneve, të kabineteve, klasave, përditësimi dhe rritja e pajisjeve të laboratorëve dhe i fasiliteteve teknike e mirëmbajtja e tyre;

e. Shtim dhe rifreskim i pajisjeve dhe mjeteve didaktike të palestrave, si dhe mjeteve të tjera didaktike;

f. Rritja e të ardhurave nga shërbimet e ndryshme për të tretët;

g. Rritja e të ardhurave nga projektet dhe format e tjera të kërkimit shkencor;

h. Përditësimi, përpunimi dhe funksionimi i një sistemi të plotë e të saktë informacioni.

Për zhvillimin e Teknologjisë së Informacionit

- Krijimi i sistemit dixhital të menaxhimit të kërkimit shkencor
- Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve të disponueshme TI.
- Dixhitalizimi i Arkivës së UST-së.
- Dixhitalizimi i Bibliotekës së UST-së.
- Dixhitalizimi i Financës dhe Magazinës.
- Përmirësimi i pasjeve shpërndarëse të internetit.
- Përmirësimi i rrjetit të brendshëm të shpërndarjes.
- Plotësimi i stafit akademik dhe administrativ me kompjuter dhe pajisje të tjera ndihmëse.
- Plotësimi i laboratorëve me pajisje dhe programet përkatëse.
- Plotësimi i auditorëve me pajisje kompjuterike dhe ndihmëse.

Veprimet

- Do të mbrojmë burimet tona kryesore të të ardhurave dhe do të përmirësojmë konkurrencën përmes një përqasjeje të fokusuar dhe të orientuar drejt tregut për ofertën tonë arsimore.
- Do të përshtatim me shpejtësi portofolin tonë të programeve të studimit në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

- Do të diversifikojmë dhe rritim të ardhurat tona përmes tarifave, kërkimit dhe shërbimeve akademike, partneriteteve e projekteve kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Do të ndërmarrim një qasje të menaxhuar dhe të planifikuar me kujdes në plotësimin e kësaj strategjie, duke udhëhequr me iniciativa për të përmirësuar kapacitetin, produktivitetin dhe efikasitetin për të arritur përfitime në fillim, duke gjeneruar burime financiare shtesë për realizimin e investimeve.
- Do të bashkëpunojmë me institucione të ndryshme për të patur mbështetje në financimin e projekteve madhore që kërkojnë shumë financim.
- Rikonstruksion i godinave ambienteve dhe palestrave sportive dhe godina shtesë, godinë të re, për përmirësimin e kushteve dhe standardeve përkatëse, në shërbim të stafit dhe të studentëve, planifikime të detajuara të përvitshme.
- Fuqizimi i laboratorëve, plane konkrete të përvitshme më pajisje të standardizuara në shërbim të procesit kërkimor, shkencor.
- Përmirësimi i vazhdueshëm i auditorëve me pajisje, mjete kompiuterike, orendi e pajisje të tjera. Planifikime konkrete të përvitshme.
- Investime, riparim i godinave, ambienteve, terreneve sportive, palestrave, shtim i pajisjeve të ndryshme. – Planifikim mujor në proces i nivelit të mirëmbajtjes të sallave të leksioneve, të kabineteve, klasave, të laboratorëve dhe i fasiliteteve teknike.
- Mirëmbajtje e infrastrukturës së sportit, si palestra, fushat e terrenet sportive, pajisjet e materialet didaktike për to, planifikime të përvitshme.
- Rregullimi multifunksional i fushave të tenisit në shërbim të procesit mësimor dhe studentëve dhe për t'u përdorur për shërbime me të tretë.
- Pajisja me mjete didaktike, gjendja, nevojat, llojshmëria, rifreskimi dhe shtimi tyre. Planifikim konkret i përvitshëm.
- Sistemimi i të gjithë laboratorëve, pasurimi dhe kompletimi tërësor i tyre në nivelin bashkëkohor dhe shfrytëzimi efektiv i tyre.
- Pasurimi i bibliotekës me libra, periodikë, digjitalizimi i plotë i saj. Sigurimi i e-book.
- Digjitalizimi i plotë i sekretarisë mësimore, arkivës dhe financës.
- Mirëmbajtje e infrastrukturës TI në auditorë, laboratorë, biblioteka, sallat e teknologjisë, pajisja e pasurimi me mjete didaktike e elektronike etj.

Rezultatet e pritshme

- Politika e re mbi marrëdhëniet midis UST-së dhe burimeve të financimit.
- Politika e re për tarifat dhe pagesat e shërbimeve të ofruara nga UST.
- Infrastrukturë e përmirësuar, shërbime më të mira TI dhe digjitalizim në disa sektorë.
- Krijimi i fondit të stimujve.

Objektivi gjashtë: Ndërtimi i markës dhe konsolidimi identitetit të UST

UST ka nevojë të marketohet si kurrë më parë për shkak të ndryshimit të shpejtë të tregut. Rritja e konkurrencës në treg me aktorë të rinj të cilët ofrojnë programe studimi të njëjta apo të ngjashme me ato që UST ofron, për regjistrimin e studentëve ka krijuar një nevojë të fortë që UST të dallojë vetveten. Ne duhet të kuptojmë thelbin e institucionit "ADN", arenën e tij konkurruese, pozicionin e dëshiruar të tij dhe planin strategjik të markës me të cilin do të punojmë. Ne besojmë se interpretimi dhe integrimi i markës së një institucioni në një përvojë unike, të angazhuar dhe të paharrueshme është vendimtare. Sipas nesh një markë është premtimi që i bëjmë audiencës sonë, thelbi i organizatës sonë, personaliteti që përcjellim, mesazhi që japim, identiteti që shprehim. Ne konsiderojmë se shumë faktorë kontribuojnë në formësimin e një marke të një institucioni, duke përfshirë reputacionin e tij akademik, vendndodhjen dhe të diplomuar të shquar. Ne duhet të jemi mjaft të fortë për të vepruar si një "thirrje për veprim" tek audienca jonë.

Veprimet

- Të identifikojmë esencën tonë unike, të identifikojmë "ADN-në" e institucionit tonë dhe të kuptojmë përbërjen e saj; çfarë përcakton frymën dhe përvojën e UST-së; si mund të dallohemi nga institucionet analoge ndërkombëtare dhe konkurrentët.
- Të njohim audiencën ekzistuese dhe potenciale të synuar, për të kuptuar demografinë, për të identifikuar se çka motivon procesin e vendimmarrjes dhe për të arritur të prekë mendjet dhe zemrat e tyre.
- Të përgatisim një plan strategjik të markës.
- Të krijojmë një sistem të fortë dhe gjithëpërfshirës të identitetit vizual dhe veprues që të sqarojë nomenklaturën e universitetit dhe të ndihmojë në standardizimin e aplikimit të identitetit të markës në universitet.
- Të arrijmë që ta konsolidojmë edhe më shumë një prezencë të fuqishme dhe të dukshme në tregun e arsimit të lartë.
- Të krijojmë një mjedis unik, që mundëson qëndrueshmëri dhe kohezion mes pikave të kontaktit të institucionit duke përfshirë mjedisin fizik, materialet e komunikimit të marketingut , prezencën, shenjat, shfaqjet dhe ekspozitat e internetit, si një mjet simbolik për përcjelljen e një sërë besimesh që kuptohen nga publiku.
- Zbatimi i një hierarkie, qartësie dhe dokumentimi për UST-në për të gjitha subjektet.
- Projektimi i materialeve të publicitetit dhe marketingut që promovojnë një profil të arsimit ndërkombëtar dhe projektojnë fuqishëm një vlerë të dallueshme dhe të shquar të markës. Kjo duhet të mbështetet nga një staf dhe alumni që mund të udhëtojë në vende të veçanta për të folur me studentët e interesuar dhe partnerët/bashkëpunëtorët e ardhshëm.
- Të konsolidojmë zyrën për marketing dhe promovim të Institucionit.

Rezultatet e pritshme

- Plani strategjik i markës.
- Krijimi i një sistemi gjithëpërfshirës të identitetit vizual dhe veprues.
- Logo logjike dhe tërheqëse për institucionin.

- Ngjyra përfaqësuese, cilësi dhe model.
- Karakteristikat e imazhit.
- Ambientet tridimensionale (mjediset me markë, ngjarjet e veçanta), dy dimensionale (broshura, katalogë, mail direkt), virtual (web site, email "blogs", media elektronike) dhe ballë për ballë format e ndërveprimit.
- Modeli i ri web-site të UST interaktive.
- Krijimi i rrjetit të ambasadorëve të markës.

PRIORITETI STRATEGJIK 2: PËRMBUSHJA E STANDARDEVE AKADEMIKE TË PËRSOSMËRISË

Qëllimi ynë është t'u ofrojmë studentëve një përvojë arsimore që u ofron atyre mundësinë për të përmbushur potencialin e tyre si individë duke u zhvilluar brenda komunitetit tonë si studentë të pavarur, të përgatitur për të marrë përgjegjësinë për zhvillimin e tyre personal dhe profesional gjatë gjithë jetës së tyre. Baza e kësaj përvoje edukative është standardi i lartë në sigurimin e përvojave të suksesshme mësimore të mbajtura përmes zhvillimit të kurrikulumit, iniciativa të reja të mësimdhënies, kontribute dhe kritika konstruktive të bëra nga studentët, si dhe vëmendje e kujdesshme e stafit për mënyrën se si kurset dhe programet janë hartuar, zhvilluar dhe rishikuar.

Objektivi i parë: Zhvillimi i kurrikulës

Zhvillimi i kurrikulës është thelbësor për cilësinë e mësimdhënies. Ne synojmë të ndryshojmë qëllimet për të mësuar - nga theksimi në njohjen e fakteve dhe koncepteve disiplinore në theksimin e kompetencave të përcaktuara gjerësisht për të siguruar që të diplomuarit kanë aftësitë e nevojshme si qytetarë në shekullit të njëzet e një. Në këtë kontekst, qëllimi ynë është të zhvillojmë një kurrikul të bazuar në kompetenca, me në qendër studentin dhe të bazuar në kërkime shkencore.

Veprimet

- Hapja e programeve të reja të studimit në tre cikle studimi, në fokus programet e përbashkëta me partnerë EU.
- Zbatimi i qasjeve të mëposhtme në zhvillimin e kurrikulave.
- Kurrikula e bazuar në kompetencë.
- Kurrikula e përqëndruar në student.
- Kurrikula e bazuar në hulumtime.
- Përditësimi i kurrikulave ekzistuese.
- Trajnimi i pedagogëve për të shkruar rezultatet e të nxënit.

- Kodifikimin e kurrikulave dhe lëndëve.
- Krijimi i Komisionit të Sigurimit të Cilësisë.
- Monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të kurrikulave.
- Përgatitja e doracakut të studentëve.
- Vlerësimi i kurrikulës.

Rezultatet e pritshme

- Udhëzimet për zhvillimin e kurrikulës.
- Udhëzimet për të shkruar rezultatet e të nxënit.
- Paketa e kurrikulës së re.
- Buletini i programeve të studimit.
- Katalogu i kodifikimit.
- Publikimi i doracakut të nxënësve.
- Instrumentet e vlerësimit të kurrikulës.

Objektivi i dytë: Përsosmëri në mësimdhënie dhe të nxënit.

Mësimdhënia mbetet funksioni qëndror dhe të nxënit e studentit është qëllimi kryesor. Ky qëllim do të arrihet përmes vlerësimit dhe mbështetjes së inovacionit në mësimdhënie dhe promovimit të kontributeve të pedagogëve në dialogun kombëtar për mësimdhënien dhe të nxënit. Ne do të ofrojmë mbështetje të fuqishme për njerëzit efektivë, duke promovuar ngarkesën e përshtatshme dhe transparente, duke përcaktuar treguesit e performancës kërkimore dhe mësimore dhe sistemet e menaxhimit të performancës. Ne do të shqyrtojmë ngritjen e strukturave sa me profesionale për të garantuar një proces rekrutimi bazuar në meritë duke synuar përsosmëri të stafit akademik e administrativ, të talentuar që transmeton përsosmëri në arsim, hulumtim dhe përvojën studentore.

Veprimet

- Krijimi i një strukture organizative dhe sigurimi i burimeve për të avancuar mësimdhënien dhe të nxënit me qëllim të krijimit, organizimit dhe mbështetjes së programeve dhe iniciativave që lidhen me mësimdhënien inovative dhe të nxënit ndërveprues.
- Promovimi i gatishmërisë së pedagogëve për të përparuar në detyrat më sfiduese që hap mundësi për të përmirësuar përformancën e universitetit.
- Rekrutimi i pedagogëve me përvojë për të qenë katalizatorë për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, mbështetjen e inovacionit dhe zhvillimin e të nxënit të avancuar në teknologji.

- Mbështetja e pedagogëve për të arritur potencialin e tyre të plotë përmes zhvillimit profesional të vazhdueshëm.
- Zhvillimi i metodologjive të mësimdhënies bazuar në qasjen mikse të të mësuarit dhe përmirësimi i aftësitë e tyre digjitale.
- Themelimi i një fondi për të mbështetur inovacionin që nxit mësimin aktiv dhe të angazhuar.
- Zbatimi i modeleve inovative të mësimit miks, si: kombinimi i mësimit në auditor dhe jashtë tij, përfshirja e mediave sociale, LMS etj.
- Përdorimi i fidbekut mbi mësimdhënien për të njohur dhe promovuar pedagogët e shkëlqyer dhe për të vlerësuar cilësinë e programeve të mësuara.
- Zhvillimi i dokumentit të politikave për integritetin e hulumtimit të pedagogëve dhe studentëve dhe përdorimi i programit për zbulimin e plagjiaturës.
- Zhvillimi i platformës elektronike për vlerësimin e studentëve.
- Krijimi i dy çmime për pedagogët: "Pedagogu më i mirë i vitit", "Studiuesi më i mirë i vitit".

Rezultatet e pritshme

- Krijimi i Qendrës së përsosmërisë në mësimdhënie dhe të nxënit në arsimin e lartë
- Përmirësimi i cilësisë së pedagogëve.
- Trajnim për përditësimin e aftësive mësimdhënëse të pedagogëve.
- Përgatitja e materialeve mësimore dixhitale.
- Përdorimi i platformës LMS.
- Përdorimi i fidbekut të studentëve për mësimdhënien.
- Përdorimi i platformës elektronike për vlerësimin e studentëve.
- Dokumenti i politikave për integritetin e hulumtimit të pedagogëve dhe studentëve dhe programi për zbulimin e plagjiaturës.

Objektivi tre: Përsosmëri në jetën e studentëve

do të përmirësojmë më tej përvojën e studentëve tanë, duke i vendosur ato në zemër të universitetit me një theks në punën e partneritetit dhe personalizimin e mësimit. Synojmë t'u ofrojmë studentëve mundësi për të zhvilluar aftësitë, cilësitë, njohuritë dhe përvojën për t'i përgatitur ata për punësim të suksesshëm në fushën e zgjedhur prej tyre.

Veprimet

- Zhvillimi i platformës për qasjen me në qendër studentin.
- Personalizimi i përvojave e të nxënit të studentëve.

- Promovimi, mbështetja dhe sigurimi i burimeve të nevojshme për mësimdhënien e grupeve të vogla.
- Dhënia e fidbekut studentëve për përparimin dhe arritjen e tyre.
- Krijimi i hapësirave të mësimit, hulumtimit dhe hapësirave sociale që mbështesin një bashkësie akademike.
- Sigurimi i mundësive praktike për studentët në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.
- Ofrimi i mundësisë për të gjithë studentët për të përmirësuar njohuritë dhe aftësitë e tyre në hulumtim, drejtim, internacionalizim dhe qëndrueshmëri në një gamë të gjerë fushash.
- Ofrimi i orientimit në karrierë dhe zhvillimi i aftësive të punësimit në një mënyrë që është e arritshme për të gjithë studentët gjatë gjithë kohës së tyre të studimit tek ne.
- Përqendrimi i aktiviteteve të rekrutimit dhe pranimit në përmirësimin e cilësisë së studentëve që aplikojnë dhe tërheqjen e studentëve më të mirë me potencial për të arritur përsosmërinë akademike.
- Zhvillimi i dokumentit të politikave për integritetin akademik të studentëve.
- Krijimi i dy çmimeve për studentët:
  a. Çmimi "Student i Vitit", që i jepet studentit i cili ka arritur nivelin më të lartë në studimet akademike, në aktivitetet sportive, artistike, aktivizëm shoqëror.
  b. Çmimi për tezën më të mirë në Master dhe Doktoratën më të mirë të vitit.

Rezultatet e pritshme

- Zbatimi i qasjes me në qendër studentin.
- Përgatitja e politikës së praktikës.
- Konsolidimi i sistemit së rekrutimit dhe pranimit të studentëve.
- Përgatitja e politikës së rekrutimit dhe pranimit.
- Dokumenti i politikave për integritetin akademik të studentëve.
- Dhënia e çmimeve për studentët.

PRIORITETI STRATEGJIK 3: KËRKIMI

Përsosmëria në kërkime është përparësia jonë për vitet e ardhshme. Ne do të sigurojmë që të gjithë anëtarët e komunitetit akademik të angazhuar në kërkime shkencore, do të sigurojmë trajnime, burime dhe mbështetje të përshtatshme.

Veprimet

- Përgatitja e strategjisë së kërkimit.
- Krijimi i profileve të hulumtimit të institucionit.
- Identifikimi i projekteve kërkimore që kanë ndikim në zhvillimin e shoqërisë.

- Përgatitja e paketës së projekteve kërkimore.
- Përdorim i të gjitha mundësive të financimit për të mbështetur kërkimet.
- Lidhja e hulumtimit me mësimdhënien.
- Krijimi i një bazë të dhënash për hulumtim.
- Përgatitja e portofolit të kërkimit të institucionit.
- Zhvillimi i infrastrukturës kërkimore.
- Krijimi i rrjetit të studiuesve të rinj.
- Kryerja e hulumtimeve të nivelit të lartë duke sjellë risi për të mundësuar njohjen ndërkombëtare të universitetit.
- Zhvillimi i marrëdhënieve të reja kërkimore shkencore me institucionet e tjera akademike në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.
- Integrim më i mirë i UST-së në Zonën Evropiane të Kërkimit.
- Përdorimi i qasjes kurrikulare të bazuar në kërkime.
- Krijimi i Fondit të Studimit *Seedcom* për të mbështetur nismat e reja kërkimore.
- Sigurimi i një mbështetjeje financiare për pjesëmarrjen në aktivitetet kërkimore ndërkombëtare.

Rezultatet e pritshme

- Dokumenti i strategjisë së kërkimit.
- Paketa e projektit kërkimor.
- Baza e të dhënave kërkimore.
- Publikimi i vlerësimit të produkteve kërkimore.
- Themelimi dhe Funksionimi i Fondit të Kërkimit *Seedcom.*

PRIORITET STRATEGJIK 4: NDËRTIMI I PARTNERITETIT

Puna me organizatat jashtë institucionit tonë dhe ndërtimin e partneriteteve është jetësore për arritjen e vizionit të UST-së. Ne mbajmë marrëdhënie me punëdhënësit vendorë, rajonalë dhe kombëtarë në fushën e sportit, edukimit fizik, shendetit e mirëqenies, të cilët u ofrojnë mundësi për përvojë për studentët tanë dhe mundësi punësimi për të diplomuarit tanë dhe nga kjo marrëdhënie përfitojnë të dyja palët. Ne kemi një komunitet alumni dhe një pjesë e mirë e tyre janë mbështetës besnikë të institucionit tonë.

Ne duhet ta shtojmë punën tonë me një larmi më të madhe të organizatave publike, private dhe vullnetare dhe me të diplomuarit tanë për t'i kontribuar misionit tonë arsimor, për të identifikuar përparësitë e ardhshme të financimit për hulumtim dhe edukim dhe për të promovuar filantropinë për të gjeneruar burime për të mbështetur aktivitetet tona kryesore.

Objektivi i parë: Rritja e partneriteteve të jashtme për të mbështetur mësimdhënien dhe të nxënit, kërkimin dhe punësimin e studentëve.

Veprimet

- Përzgjedhja e partnerëve, pikat e forta dhe ambiciet e të cilëve janë në përputhje me tonat, për të rritur mundësitë e të nxënit të bazuar në përvojë dhe mundësitë e punësimit për studentët tanë.
- Garantimi që programet tona janë relevante për punëdhënësit dhe organizmat profesionale.
- Zgjerimi i mundësive të zhvillimit profesional për të mbështetur shkëmbimin e njohurive, ndërtimin e partneriteteve dhe gjenerimin e të ardhurave.

Rezultatet e pritshme

- Krijimi i një forumi të përhershëm me punëdhënësit.
- Zhvillimi i një instrumenti feedback për punëdhënësit.

